



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Përhershëm të Këshillit

Data e mbledhjes së Komisionit 26/05/2025

Ora e hapjes së mbledhjes 12:00

Marrin pjesë :

1. z. Altin Habip
2. znj. Ada Përmeti
3. z. Petrika Tollkuçi

Marrin pjesë gjithashtu: Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Eva Naci sekretare e këshillit

Nga ekzekutivi marrin pjesë :

1. Valbona Ziko
2. Snjel Prifti

Kryesuesi i mbledhjes është Znj. Ada Përmeti

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej 3 Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit**: Nuk ka

Pika 1 e rendit të ditës.

1. **Projekt-vendim** "PËR MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NXËNËSIN RENIS MANKOLLARI, PËR PJESËMARRJEN E TIJ NË OLIMPIADËN NDËRKOMBËTARE TË MATEMATIKËS 2025" **propozuar nga ekzekutivi.**
2. **Projekt-vendim** "PËR MIRATIMIN E ANGAZHIMIT FINACIAR TË BASHKISË KORÇË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9-VJEÇARE "SOTIR GURA DHE NDËRTIM PALESTRE", ME CIKËL FINANCIMI 2025-2026" **propozuar nga ekzekutivi.**
3. **Projekt-vendim** "PËR MIRATIMIN E ANGAZHIMIT FINACIAR TË BASHKISË KORÇË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSION I PALLATIT TË SPORTIT "TAMARA

NIKOLLA", SHITESË KATI (PUNIME FASADE) ME CIKËL FINANCIMI 2025-2026" *propozuar nga ekzekutivi.*

4. **Projekt-vendim** "PËR MIRATIMIN E RRIJES SË PLANIT TË BUXHETIT NË VLERËN 100.000 LEKË PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "RECITAL AKTORIAL" *propozuar nga ekzekutivi.*
5. RAPORT I KONSOLIDUAR PËR VEPRIMATRINË FINANCIARE DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2024

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimet

Pyetje (nga këshilltari Ada Përmeti) Detaje mbi financimin për projekt vendimin në pikën 1

Përgjigje (sqarime nga ekzekutivi) Në kuadër të mbështetjes për Renisin si talent në matematikë do të financojë shpenzimet e udhëtimit.

Pyetje (nga këshilltari Ada Përmeti) Detaje mbi investimin e shkollës « Sotir Gura ». Cfarë përfshin ?

Përgjigje (sqarime nga ekzekutivi) Financimi i kësaj shkolle do të bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit pasi Bashkia korçë ka Konkurrar dhe ka dalë fituese për grandet në arsim. Vlera e kërkuar është për financimin e mbikqyrjes dhe kolaudimit. Investimi parashikon rikonstruksionin total të shkollës dhe ndërtimin e një palestere të re. Paleta e vjetër do kthehet në klasa për mësimdhënie. Investimi përfshin edhe mobilimin dhe laboratorët.

Për Rikonstruksionin e pallatit të sportit të parashikuar në projekt vendimin sipas pikës 3 parashikohet rikonstruksioni i fasadës dhe tarracës së pallatit të sportit. Kjo vlerë është bashkëfinancim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Gjithë kjo ndërhyrje është faza e parë e investimit në objekt. Si fazë të dytë parashikohet ndërhyrja e FSHZH-së për gjithë infrastrukturën e brendshme dhe plotësimin e pallatit të sportit.

Projekt vendimi sipas pikës nr. 4 parashikon financimin e aktivitetit të recitalit të poezisë nga ana e Këshillit të Qarkut, i cili akordon këtë vlerë në Bashki për bashkëfinancim në këtë aktivitet.

Për sa i përket raportit financiar sipas pikës 5 më sipër u sqaruan:

Buxheti 2025 është realizuar në masën 76%. Zërat kryesorë të pa realizuar janë në investime. Në krahasim me 2024 janë rritur arkëtimet me afërsisht 20.000.000 lek ose 3.8%.

Shpenzimet e personelit janë realizuar në masën 92%. Janë disa shpenzime që janë planifikuar por nuk janë realizuar si kontributi në Këshillin e Qarkut.

Ndër zerat kryesorë të parealizuar janë ; Fondet për banesat të parealizuara, mbrojtja nga zjarri, investimet në pyje dhe kullota, ndërhyrja në varrezat, biblioteka Thoma Tutrulli, investimet në arsimin parauniversitar, shpenzime në institucionet e varësisë.

Diskutime :

Këshilltari Ada Përmeti diskutoi mbi tatimin e të ardhura nga dhënia e dhomave me qera ditore (Air B&B etj), pavarësisht se nga tatimet, pjesa e që i takon Bashkisë nga tatimi i ta ardhurave nuk vjen i specifikuar duhet të bashkëpunohet pasi me ndryshimet ligjore për futjen në skemën e tatimit mbi të ardhurat të personave që japin me qera ditore duhet të ketë edhe ndryshim të vlerës që duhet ti kalojë bashkisë nga ky zë.

Duhet parashikuar në investimet në shkollat që ka mundësi për të ndërtuar sinjalistikë rrugore me qëllime ndërgjegjësimi dhe edukimi të fëmijëve.

Duhet të tregohet kujdes në investimet e reja që realizohen për të parashikuar menyrat e reja të shfrytëzimit të energjisë diellore pasi ka mundësi të gjetjes së financimeve në këtë drejtim me fonde nga donatorë të huaj. Mund të bashkëpunohet edhe me FSHZH-në në këtë drejtim.

Këshilltari Petrika Tollkuçi. Duhet të kihet parasysh edhe ndërtimi së shpejti i rrjetit të ri të furnizimit me gaz për të përshtatur investimet e reja në shkolla dhe objekte me këtë infrastrukturë të re.

Mbyllet diskutimi

Përgatitet Vendimi i mbledhjes së Komisionit që do t'i paraqitet këshillit ne seancë.

Vendimi i komisionit u përgatit nga sekretari i Komisionit

Lexohet Projekt-Vendimi i Komisionit nga Kryetari / zëvendëskryetari

U votua Projekt-Vendimi 1: PRO 3 KUNDER 0 ABSTENIM 0 . Miratohet

U votua Projekt-Vendimi 2: PRO 3 KUNDER 0 ABSTENIM 0 . Miratohet

U votua Projekt-Vendimi 3: PRO 3 KUNDER 0 ABSTENIM 0 . Miratohet

U votua Projekt-Vendimi 4: PRO 3 KUNDER 0 ABSTENIM 0 . Miratohet

U votua raporti: PRO 3 KUNDER 0 ABSTENIM 0 . Miratohet

Mbyllet mbledhja e Komisionit

Ora e mbylljes së mbledhjes 13 :00

Nënshkruhet procesverbali i mbledhjes së komisionit

Kryetari i Komisionit

Sekretari i Komisionit